



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

### **KRITERET DHE DOKUMENTAT PËR HARTUES**

Kandidatët e interesuar për të marrë pjesë si hartues në provimet e sezonit 2020/2021 dhe që plotësojnë kriteret e rregullores “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për Auditues Ligjorë dhe Kontabilist të Miratuar”, e ndryshuar, duhet të paraqesin pranë sekretarisë teknike dokumentat si më poshtë.

#### **Kriteret që duhet të plotësojnë hartuesit janë si më poshtë:**

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose
- ii. Gradë apo titull shkencor apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
- iii. Si dhe përveç pikës i ose pikës ii, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore.

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale sëbashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë sekretarisë teknike pranë organizatën profesionale IEKA (një kopje e kërkesës së bashku me dokumentacionin dorëzohet pranë Strukturës Mbështetëse të BMP në rrugë postare ose elektronike).

Të gjithë hartuesit do të jenë subjekt i verifikimit për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe kuadrit rregullator.

Dorëzimi i dokumentacionit pranohet deri në datën 14 Dhjetor 2020 ora 16:00 .